



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 janar 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit
sipas Rregullës 153 (F02765)**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 11 dhjetor 2024, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W01234, W01338, W01743, W04423, W04570, W04696, W04812, W04859 dhe W04860 sipas Rregullës 153 dhe Mocionin Përkatës të Mbrojtjes për Përfashtimin e Provave ("Vendimi i Kundërshtuar").¹
2. Më 18 dhjetor 2024, ekipet e Mbrojtjes të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (së bashku, "Mbrojtja" dhe "të akuzuarit") dorëzuan një kërkesë të përbashkët për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").²
3. Më 13 janar 2025, pas autorizimit nga Trupi Gjykues,³ Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi përgjigje ndaj Kërkesës së Mbrojtjes ("Përgjigja").⁴
4. Mbrojtja nuk iu kundërpërgjigj Përgjigjes.

¹ F02765, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W01234, W01338, W01743, W04423, W04570, W04696, W04812, W04859 dhe W04860 sipas Rregullës 153 dhe Mocionin Përkatës të Mbrojtjes për Përfashtimin e Provave*, 11 dhjetor 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02765/RED).

² F02796, Mbrojtja, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit sipas Rregullës 153 (F02765)*, 18 dhjetor 2024, konfidencial.

³ F02800, Trupi Gjykues, *Urdhër për Zgjatjen e Afateve për Parashtrime dhe Rishikimin e Transkripteve të Seancave Private gjatë Periudhës së Pushimit Dimëror të Gjykatës*, 19 dhjetor 2024, para. 15(b).

⁴ F02828, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit sipas Rregullës 153 (F02765)*, 13 janar 2025, konfidenciale.

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja kërkon Leje për Apelim të Vendimit të Kundërshtuar në lidhje me një pikë, përkatësisht:

Nëse Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se përgjigjja e Mbrojtjes ndaj mocionit të ZPS-së sipas rregullës 153 nuk është rruga procedurale e duhur për mjetin juridik të kërkuar, konkretisht, pranimin e deklaratave ose materialeve shtesë sipas rregullës 153, të cilat do t'i jepnin Trupit Gjykues versionin më të vërtetë dhe më të plotë të dëshmisë së dëshmitarit në fjalë ("pika e kundërshtuar").⁵

6. Mbrojtja parashtroi se pika e kundërshtuar përmbush standardin e lejes për apel sepse: (i) ajo buron nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nuk është thjesht mospajtim me atë vendim;⁶ (ii) mund të ndikojë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;⁷ dhe (iii) kërkon marrjen e një vendimi të menjëhershëm nga Gjykata e Apelit për t'i kontribuar thelbësisht ecures së gjykimit.⁸

7. ZPS-ja përgjigjet se pika e kundërshtuar nuk është e apelueshme dhe se dhënia e lejes për apel nuk do të kishte ndonjë ndikim.⁹ Rrjedhimisht, ZPS-ja kërkon që Kërkesa të hidhet poshtë.¹⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

8. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi i miratimit të lejes për apel, i përcaktuar në këto dispozita. Rregulla 77(2) përcakton se:

Trupi Gjykues miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet

⁵ Kërkesa, para. 2, 29.

⁶ Kërkesa, para. 12. *Shih edhe* Kërkesën, para. 13-24.

⁷ Kërkesa, para. 12. *Shih edhe* Kërkesën, para. 25-26.

⁸ Kërkesa, para. 12 *Shih edhe* Kërkesën, para. 27-28.

⁹ Kërkesa, para. 2-10.

¹⁰ Kërkesa, para. 1, 12.

dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

Trupi Gjykues përfshin përmes referimit dispozitat ligjore përkatëse mbi standardin ligjor të miratimit të lejes për apel, të përcaktuar në vendime të mëparshme.¹¹

IV. DISKUTIM

9. Mbrojtja parashtroi se, në arsyetimin në lidhje me W04570-ën dhe W04812-shin, Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se Përgjigjja e Mbrojtjes ndaj Mocionit të ZPS-së sipas Rregullës 153 nuk është instrumenti i duhur procedural për pranimin e deklaratave apo materialeve shtesë sipas rregullës 153.¹² Mbrojtja argumenton se duke qenë se ky konstatim: (i) është në kundërshtim me precedentin e vendosur nga vetë Trupi Gjykues për këtë aspekt;¹³ (ii) është parimisht i gabuar dhe në kundërshtim me kryerjen me drejtësi të procesit;¹⁴ dhe (iii) vë në rrezik asnjësinë dhe funksionin e Trupit Gjykues për zbulimin e së vërtetës.¹⁵ Sipas Mbrojtjes, Trupi Gjykues ka miratuar më parë një kërkesë të ngjashme në lidhje me materialin e W01237-ës sipas rregullës 153, duke konstatuar të pranueshëm një formular të OSBE-së që lidhej me këtë dëshmitar, pas një kërkesë të Mbrojtjes në përgjigje të një kërkesë tjetër të ZPS-së sipas rregullës 153.¹⁶ Gjithashtu, Mbrojtja

¹¹ *Shih p.sh.* F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit për Dëshmitarët me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8, që i referohet KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Miratimin e Lejes për Apelim të F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

¹² Kërkesa, para. 13.

¹³ Kërkesa, para. 14-17.

¹⁴ Kërkesa, para. 18-23.

¹⁵ Kërkesa, para. 24.

¹⁶ Kërkesa, para. 15, që i referohet F01904, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153*, 3 nëntor 2023, konfidencial, para. 16-20 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 nëntor 2023, F01904/RED); F01688, Mbrojtja, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj*

argumenton se Trupi Gjykses nuk ka paraqitur ndonjë justifikim për shmangien nga ky “precedent i qartë” dhe, sipas Mbrojtjes, një justifikim i tillë nuk ekziston.¹⁷ Së dyti, Mbrojtja argumenton se nuk është e lejueshme që pala e cila nuk po paraqet dokumente për pranim të kërkojë të përdorë rregullën 153 për pranimin e dëshmisë së një dëshmitari në të cilit ajo palë nuk mbështetet dhe të cilin nuk do ta thërrasë e as mund ta thërrasë për të dëshmuar gojarisht në rrethana kur ajo i kundërshton hapur ato prova dhe pranimin e tyre nëpërmjet asaj rregulle.¹⁸ Së treti, Mbrojtja argumenton se duke refuzuar pranimin e provave shitesë që do t’i jepnin Trupit Gjykses versionin më të vërtetë dhe më të plotë të ngjarjeve, Trupi Gjykses refuzon të pranojë të vërtetën.¹⁹ Mbrojtja parashtro se kjo është në kundërshtim me funksionin e Trupit Gjykses për kërkimin e së vërtetës dhe me të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë.²⁰

10. ZPS-ja përgjigjet se pika e kundërshtuar nuk është e apelueshme sepse nuk buron nga Vendimi, është hipotetike dhe përbën thjesht mospajtim me vendimin e Trupit Gjykses.²¹ ZPS-ja parashtro se ushtrimi nga ana e Trupit Gjykses i diskrecionit për të pranuar, si rast përjashtimor, një provë të pakundërshtuar nga palët që u paraqit për pranim përmes një përgjigjeje – që nuk është rruga procedurale e duhur – nuk përbën precedent detyrues.²² Gjithashtu ZPS-ja parashtro se argumentet e Mbrojtjes se Trupi Gjykses refuzon të pranojë të vërtetën janë të pabaza, sepse Mbrojtja është e lirë të paraqesë prova në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren.²³

Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Provave nga Dëshmitarët W01237, W04594, W04592, W04872, W04871, W04673 dhe W04362 sipas Rregullës 153, 20 korrik 2023, konfidenciale, para. 16-19 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 17 nëntor 2023, F01688/RED).

¹⁷ Kërkesa, para. 17.

¹⁸ Kërkesa, para. 23. *Shih edhe* Kërkesën, para. 18-23.

¹⁹ Kërkesa, para. 24.

²⁰ Kërkesa, para. 24.

²¹ Përgjigjja, para. 2. *Shih edhe* Përgjigj, para. 3-5.

²² Përgjigjja, para. 3.

²³ Përgjigjja, para. 7.

11. Trupi Gjykues vëren se në Vendimin e Kundërshtuar ai konstatoi, ndër të tjera, se provat e W04570-ës dhe W04812-tës, të paraqitura nga ZPS-ja, janë të përshtatshme për t'u pranuar sipas rregullës 153. Trupi Gjykues trajtoi edhe kërkesën më vete të Mbrojtjes për pranimin e provave shtesë për W04570-n dhe W04812-shin, që Mbrojtja e paraqiti në përgjigjen ndaj mocionit të ZPS-së sipas rregullës 153.²⁴ Në lidhje të, Trupi Gjykues konstatoi se përgjigjet ndaj mocioneve nuk janë rruga procedurale e duhur për të kërkuar një mjet juridik, si pranimi i disa provave, që nuk ka lidhje me aspektin nën shqyrtim dhe, rrjedhimisht, nuk pranoi ta shqyrtonte atë mjet juridik në atë fazë.²⁵

12. Në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,²⁶ fakti që në rastin e vetëm që përmend Mbrojtja Trupi Gjykues ushtroi diskrecionin e tij dhe pranoi, si rast përjashtimor, një provë të pakundërshtuar nga palët që u paraqit për pranim përmes një përgjigjeje – që nuk është rruga procedurale e duhur – nuk përbën precedent detyrues.

13. Sa u përket argumenteve të Mbrojtjes se konstatimi i Trupit Gjykues është në kundërshtim me parimet ligjore bazë dhe drejtësinë e procesit, si edhe me funksionin e Trupit Gjykues për kërkimin e së vërtetës,²⁷ Trupi Gjykues vëren se nuk ka marrë vendim mbi pranueshmërinë e provave shtesë të W04570-ës dhe W04812-ës dhe se Mbrojtja, nëse dëshiron, ka mundësinë të kërkojë pranimin e atyre provave shtesë, nëse dëshiron, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren. Nëse dhe kur Mbrojtja do t'i ofrojë ato prova në përputhje me Rregulloren, Trupi Gjykues do të vendosë mbi pranimin e tyre.

14. Për këto arsye Trupi Gjykues është i mendimit se pika e paraqitur për leje për apel shtrembëron konstatimet e Trupit Gjykues dhe përbën thjesht mospajtim me

²⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 48, 64

²⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para 48, 64.

²⁶ Kërkesa, para. 14-17.

²⁷ Kërkesa, para. 18-24.

to. Rrjedhimisht Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se ajo përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

15. Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e mbetura të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) në lidhje me pikën e kundërshtuar. Kërkesa për leje për apelimin e saj rrjedhimisht rrëzohet.

V. KLASIFIKIMI

16. Trupi Gjykses vëren se Kërkesa është dorëzuar si konfidenciale. Rrjedhimisht Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen të kërkojë riklasifikimin ose të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës deri **të martën, 28 janar 2025**.

17. Duke vërejtur se ZPS-ja nuk kundërshton riklasifikimin e Përgjigjes si publike dhe duke pasur parasysh se Përgjigjja nuk përmban informacion konfidencial, Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative ta riklasifikojë Përgjigjen si publike.

VI. VENDIM

18. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **RRËZON** Kërkesën;
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen të kërkojë riklasifikimin ose të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës deri **të martën, 28 janar 2025**; dhe
- c) **UDHËZON** Zyrën Administrative ta riklasifikojë Kërkesën (F02828) si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 21 janar 2025

Në Hagë, Holandë.